

PRANIA E MITIT NË VEPRËN “KËSH TJELLA” TË KADARESË

Rëndësia e kësaj analize konsiston në shfaqjen dhe trajtimin e elementeve mitike në veprën “Kështjella” të Ismail Kadaresë, për të hedhur dritë në anën strukturore të veprës, me qëllim shfaqjen e rëndësisë së saj në rrafshin dhe në meritat letrare. Vëzhgimi kryhet nisur prej leximeve në rrafshin antropologjik dhe prej studimeve letrare të cilat vërtiten në të njëjtin qerthull.

Në kapitullin e dytë, të “Mendim i egër”, Klod Levi-Shtraus (Claude Levi-Strauss) “Logjikën e klasifikimeve totemike” e nis me paragrafin hyrës:

“Ka, gjithsesi, diçka paradoksale në idenë e logjikës, termat e së cilës konsistojnë në grimca e copëza, mbeturina të proceseve psikologjike e historike dhe, si të tilla, më nuk janë të domosdoshme. Kush thotë logjikë, mendon, megjithatë, instalimin e marrëdhënieve të domosdoshme; por, si do të vendoseshin marrëdhëniet e këtilla në mes termave që nuk përcaktojnë asgjë në kryerjen e funksionit të tillë? Fjalitë mund të lidhen në mënyrë të saktë vetëm nëse termat e tyre kanë qenë më përpara të përkufizuara pa asnjë paqartësi. A nuk e morëm mbi vete, në faqet e mëparshme, qëllimin e pamundshëm për të zbuluar kushtet e një domosdoshmërie aposteriori?”¹

Shtrausi është përpjekur të na bëjë të vetëdijshëm rreth rëndësisë që mbart një funksion i tillë logjik për t’i lënë shteg një analogjie e cila na çon në përkufizimin e mitit. Ai shkruan po aty:

“Imazhet shënjuese të miteve, materialet e mjeshtëruetit, janë elemente të përkufizueshme me një kriter të dyfishtë: ato kanë shërbyer si fjalë të një diskursi, të cilin refleksioni mitik “e zbërthen” në mënyrën e mjeshtëruetit që ruan me kujdes dhëmbëzoret e çmontuara të orës së vjetër me zile; ato mund të shërbejnë ende për

1 Claude Levi-Strauss, *Mendim i egër*, Dukagjini – Pejë, 1999, f. 59.

të njëjtin qëllim, apo për një përdorim tjetër, nëse i devijojmë vetëm pak nga funksioni i tyre i parë”.²

Nëse rrekemi të ecim në një vijë të drejtë të këtij mendimi në romanin “Kështjella”, subjekti është i ndërtuar në një kohë të largët, ngjarjet janë spostuar në kohën e Perandorisë Osmane dhe të Skënderbeut, në kohën e kështjellave dhe të perandorive, në kohën kur pritet një luftë me Kostandinopolin dhe, në fund, autori vë në gojën e personazheve se “*Çfarë është një shtet*”. E gjitha kjo, në kohën kur Kadareja po shkruante romanin, ishte një kohë e largët, e cila në sytë e lexuesit për nga rëndësia vjen vetëm në formën e mitit. Duke zgjedhur një perandori si subjektin kryesor, në rastin e “Kështjellës” nuk kemi personazhe të hiperbolizuara prej autorit, të cilët synojnë të zënë vendin e parë për nga rëndësia e masës përshkrimore nga ana e tij. Madje kemi një rend të caktuar personazhesh, të radhitur sipas funksionit të tyre, sikurse hierarkia e një perandorie dhe Skënderbeu, nga ana tjetër, si figura qendrore e kështjellës, në këtë rast e shqiptarëve. Hiperbolizimi i këtyre personazheve vjen vetëm si rast i figurave të përdorura nga autori në përshkrimin e tyre, duke u rrekur të bëjë portretin dhe dialogët, të cilat i vendos në gojën e tyre.

Një tjetër element mitik ndihet në fjalëformimin, në zgjedhjen e emrave të personazheve, jo vetëm në zgjedhjen e emrave të vjetër, por dhe aq të goditur për nga rëndësia dhe mesazhi që përcjellin.

*“Një copë herë qëndroi ashtu, në këmbë. Larg, lodërtitë e shiut po binin përzishëm. Kur ndjeu turbullirën e parë, u mbështet mbi nënkresë dhe mbylli sytë. Mendimet që i erdhën në çastet e fundit, nuk ishin shumë të lidhura. Ai deshi të mendonte diçka madhështore, por s’ishte e mundur. Kështu, pra, Ugurlu Tursun Tunxhasllan Sert Ollgun Pasha, – tha me vete. Pastaj, përpara se t’i lutej Zotit ta falte, mendoj diçka për jetën e tij dhe nëse ishte e nevojshme të krijoheshin emra kaq të gjatë për jetën e shkurtër njerëzore dhe për atë që ai bëri gjithçka, por s’kishte qenë e mundur, ah, kurrsesi s’kishte qenë e mundur, dhe diçka tjetër, më tepër një aht, për botën gjithë zhurmë që mbetej këndeje, ndërsa shpirti i tij ikte i vetëm nëpër shi”.*³

Megjithatë, në romanin “Kështjella” kemi një mozaik personazhesh dhe njëkohësisht një mozaik emrash. Kemi Ajselin, Lejlanë dhe Exherin. Duke

2 Po aty.

3 Ismail Kadare, *Kështjella*, “Onufri”, 2015, f. 277.

u përpjekur për t'ia lënë studimit në rrafshin historik se sa të përdorur kanë qenë këta emra në të vërtetë në periudhën në të cilën shkrimtari ka synuar të vendosë subjektin e tij, le të përpiqemi të justifikojmë ndonjë lajthitje në pretendimin e tezës së ngritur për studim, duke u rrekur nëpërmjet shpjegimeve psikologjike dhe duke u përpjekur kështu edhe për të vënë në pah interesin e autorit rreth mitit dhe dialogut modern, sikurse letërsia moderne, të cilën miti nuk e zbeh aspak, përveçse e bën një vepër me vlera të larta stilistike dhe të denjë për një letërsi të mirëfilltë.

Roland Barthes (Barthes) në parathënien e “Mitologjisë” shkruan:

*“Që në fillim, nocioni i mitit m'u duk se e jepte mjaft qartë idenë e këtyre qartësish të rreme: atëherë e merrja fjalën në kuptimin e saj tradicional. Por isha tashmë i bindur për një gjë, nga e cila më pas u rreka të përftoj të gjitha rrjedhojat: se miti është një ligjërime. Gjithashtu, duke u marrë me fakte në dukje tepër larg prej çdo tipi letërsie (një ndeshje keçi, një recetë kuzhine, një ekspozitë plastike), nuk mendoja të dilja nga kjo semiologji e përgjithshme e botës sonë borgjeze, anën letrare të së cilës e kisha trajtuar në ese të mëparshme. Vetëm pasi shqyrtova një numër faktesh të aktualitetit, u tundova të ndërmerrja një përcaktim metodik të mitit bashkëkohor: tekst që, kuptohet, e lashë në fund të këtij vëllimi, përderisa s'bën gjë tjetër, veçse sistemon materiale të mëparshme”.*⁴

Ndërsa i referohemi paragrafit të Bartesit, mund të themi që Ismail Kadare, nëpërmjet emrave me nuance, ka dashur të na përcjellë një mesazh po aq kuptimplotë, duke iu referuar periudhës historike dhe prej fjalëformimit një prurje të re, ose thënë ndryshe një ligjërime bashkëkohor, i cili rreket të shprehë një mit për nga rëndësia. Kjo duket te Lejlaja, kjo grua e cila është më e pjekur se të tjerat dhe e përzgjedhur për të qenë personazh në Perandorinë Osmane. Kështu, mbase e tërë vepra është krijuar si një vepër historike për nga rëndësia, duke iu përmbajtur mitit të së shkuarës. Mbase kësaj i referohet edhe Mateo Mandale te “Hora e Arbëreshëvet”. Ndër të tjera, ai shkruan:

*“Sfida e vërtetë e “Kështjellës” është përsëritja e një letërsie që, nga njëra anë, i duhej të mbrohej për të mos u asgjësuar e, nga ana tjetër, i duhej të flijohej për t'u ringjallur”.*⁵

⁴ Roland Barthes, *Mitologjia*, “Pika pa sipërfaqe”, 2016, f. 26.

⁵ Matteo Mandala, *Hora e Arbëreshëvet*, tetor 2007.

Për më shumë, në veprën “Kështjella” hasemi me personazhe dhe fate atipike, si me një poet i cili verbohët, një fat i parashkruar, me një arkitekt i cili qëndron shumë lart nga ana profesionale, madje pritet prej tij të bëjë shkumb e hi Kostandinopolin dhe një Skënderbe i cili del rrallë. Të gjitha këto janë përpjekje e autorit për të sjellë figura mitike, si rasti i poetit të verbuar. Megjithatë, romani “Kështjella”, botuar nga shtëpia botuese “Onufri”, në vitin 2015, është një vepër e cila na vjen me paragrafë në fillim të çdo kapitulli, me një parashtrim të ngjarjeve, me një subjekt prej të cilit priten ngjarje të mëdha, sepse është fokusuar vetëm në pushtimin e kështjellës me personazhe të zgjedhura. E gjitha kjo vjen me një gjuhë moderne, një mendim më të emancipuar, lirshmëri mendimi dhe që të detyron të bësh reflektime kundrejt ngjarjeve historike dhe jo atyre bashkëkohore.

Megjithatë, duke besuar në një gjuhë moderne dhe duke pasur mirëbesimin se autori ka dëshiruar të na sjellë nëpërmjet një ngjarjeje historike një letërsi moderne, le të rrekemi t’i qëndrojmë besnik postulatit të Tynjanov, i cili shprehet:

*“Studimi i evolucionit të letërsisë është i mundur vetëm duke iu referuar letërsisë si seri, apo sistem në korrelacion me seri, apo sisteme të tjera, dhe i kushtëzuar prej tyre”.*⁶

Ky evolucion letrar, thënë prej Tynjanov, gjën pasqyrim në veprën e Roland Bartes, “Mitologjitë”, sipas së cilit janë shtjelluar fillimet që nga mitologjitë e hershme, deri te miti sot. “Miti është një thënie”, “Miti si sistem semiologjik” etj., janë shkrime të autorit që na vijnë sipas një rendi të caktuar në veprën e tij “Mitologjitë”, për të na treguar më konkretisht mitin në vetvete dhe format që ai merr. Kështu, tuneli i hapur nga dora e arkitektit për të shtënë kështjellën në dorë, nëpërmjet një veprimi të zgjuar, na lë vend për aludime se Ismail Kadare ka zgjedhur “Kalin e Trojës” për të pushtuar një kështjellë, edhe pse këtu na vjen një skicë prej zgjuarsisë së një arkitekti. Kjo është një tjetër mundësi e ardhjes së mitit në forma të reja dhe pse jo, në trajta letrare, duke u zhveshur nga kuptimi parësor i tyre.

“Ata ndiqnin me sy dorën e zbehtë si qiriri, që ndehej mbi vizatimet e çuditshme, duke u mahnitur, si zakonisht, për faktin se si një gjë e njëmendtë dhe gjithsesi e rrokshme, si kështjella, mund të shkërbehej nga ca vija të holla e të mjera, që tregonin jo vetëm

6 Jurij Tynjanov, *L'evoluzione letteraria*, në “I formalisti russi”, a cura di T. Todorov, Einaudi, Torino, 1968, f. 142.

pjesët e dukshme, po edhe pjesët e padukshme të saj, duke filluar nga shkallët e gjer të thellësitë e themeleve, ato të cilat syri njerëzor nuk mund t'i shihte kurrë. Në të vërtetë, feja e shenjtë e Islamit e kishte theksuar disa here, se në vizatimet dhe pikturat kishte diçka djallëzore, por ata ishin të detyruar t'i pranonin ato, duke shpresuar në enigmën e tyre, ashtu siç kishin shpresuar më parë në vizatimet si lesh arapi të Saruxhait, prej të cilave kishin lindur pastaj vërtet topat përbindësia. Dora e arkitektit lëvizte pa pushim mbi vizatimet. Ai tregonte shtresat e buta dhe shtresat më të forta rreth kështjellës, duke shpjeguar se në hapjen e zgavrinës toka e butë ka një të mirë, se gërmohet shpejt, por është e paqëndrueshme, kurse e forta, mihet me vështirësi, por, kur hapet, nuk ka rrezik shembjeje. Ai shpjegonte se ç'rhellësi duhet të kishte zgavrina në fillimin e saj, sa duhej të arrinte thellësia, kur të kalonte nën themelet e kështjellës dhe si, më tutje, ajo duhej të ndahej në dy degë, në mënyrë që, po të pumbosoj njëra anë, të mbetet tjetra. Ai shpjegoi pastaj sa kohë duhej për të hapur atë tunel dhe sa ushtarë mund të kalonin nëpër të për një kohë të caktuar”.⁷

Duke besuar në evolucionin letrar, me praninë e mitit në të, si një pjesë e pandashme, urojmë që një shtjellim i tillë i veprës “Kështjella”, në të cilën kemi pretenduar praninë e komponentëve të tillë për një letërsi me vlera për nga përmbajtja dhe duke i lënë vend të pazgjdhshmes e cila vjen prej letrares, shpresojmë të kemi nxjerrë sadopak në pah vlerat e kësaj vepre.

Bibliografia

1. Claude Levi – Strauss, “Mendim i egër”, Dukagjini, Pejë, 1999.
2. Roland Barthes, “Mitologjitë”, “Pika pa sipërfaqe”, 2016.
3. Matteo Mandala, “Hora e Arbëreshëvet”, tetor, 2007.
4. Ismail Kadare, “Kështjella”, Onufri, 2015.
5. Jurij Tynjanov “L'evoluzione letteraria”, në “I formalisti russi”, a cura di T. Todorov, Einaudi, Torino, 1968.

7 Ismail Kadare, *Kështjella*, Onufri, 2015, f. 96-97